

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELQ ZA RAZMATRANJE NABAVKI

215 117

12.07.17

PRISHTINË - PRISTINA

"BENI DONA PLAST"
18/2017
12/07/2017
PRISHTINE-PRISTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: *Policia e Kosovës*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 214/17/1875/2-2-1 dhe ai i brendshëm: 214/17/037/221

Sa i përket tenderit për: Kunder Njoftimit për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit :Shërbime Hoteliere në Hapësirat e Objekteve të PK-së (Lot 1 dhe Lot 2)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Kompania 'BENI DONA' Plast Shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Imzot Nikë Prelaj, Ulpianë ,pn

(Adresa)

Komuna e Prishtines

(Vendi)

(Numri i telefonit)

Z. Ragip Mustafa

(Emri i plotë i përfqesuesit të kompanisë suaj)

mustafa@hotmail.com

(Adresa elektronike)

11 .07.2016

(Data e parashtrimit të ankesës)

10000

(Kodi postar)

(Numri i faks-it)

(Nënshkrimi i dërguesit)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjërë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Pas analizimit të dosjes së tenderit për prokurimin e Shërbime Hoteliere në Hapsirat e Objekteve të PK-së me nr. prokurimi 214/17/1875/221 dhe ato të brendshëm:214/17/037/22 konstatohet se Vendimi i Autoritetit Kontraktues për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit si dhe Letra standarde për eliminim është i paligjshëm ngase është bërë në kundërshtim me nenet e përcaktuara më poshtë duke demtuar interesin materialo - financiar të Kompanisë 'BENI DONA PLAST'ShpK në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Shkeljet e dispozitave ligjore nga Policia e Kosovës janë mëse vijon:

- Eshtë shkelur neni 1, i Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (hfrytëzimi efektiv transparent dhe i drejt i fondeve publike); i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092
- Eshtë shkelur neni 6, i Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (kost efektiviteti dhe ekonomiciteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092
- Eshtë shkelur neni 59, i Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 (ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092
- Është shkelur neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe
- Eshtë shkelur neni 10, i Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04 / L – 042 Mjetet për promovimin e Transparencës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'BENI DONA PLAST'ShpK më poshtë do të prezentojë faktet dhe argumentet në mënyrë të qartë dhe koncize për të demonstruar gabimet dhe shkeljet ligjore të Autoritetit Kontraktues për tenderin: Shërbime Hoteliere në Hapsirat e Objekteve të Policisë së Kosovës me nr. prokurimi 214/17/1875/221 dhe ato të brendshëm 214/17/037/221

Kompania 'BENI DONA PLAST'ShpK në bazë të nenit 111, paragrafi 1, nenparagrafi 1.5 të LPP-së ka interes materialo-juridik në parashtrimin e Ankesës në Organin Shqyrtues të Prokurimit nga se

është dëmtuar rëndë nga Vendimi i Autoritetit Kontraktues në Anulimin e Tenderit sepse ka qenë Ofertuesi i përgjegjshëm dhe ka plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e percaktuara në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Pikat e ankesës – argumentet e potencuara janë mëse vijon:

Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës, me datën 26.06.2017 ka publikuar Njoftimin për Anulimin e aktivitetit të prokurimit për Shërbime Hoteliere në Hapësirat e Objekteve të Policisë së Kosovës me nr. prokurimi 214/17/1875/221 dhe ate të brendshëm 214/17/037/221. ndërsa me datë 27.06.2017 në e-Mailin zyrtarë të Kompanisë Beni Dona Plast Shpk ka përcjell Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar sipas tyre se një dispozitë në Ligjin e Prokurimit Publik kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit (Njoftimi për Anulim) ndërsa sipas Letrës standarde citojnë: se Kompania Beni Dona Plast Shpk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara, mirëpo nuk mund të jetë e përgjegjshme për arsye se çmimet e ofruara nga operatori ekonomik janë çmime të larta të krahasuara me çmimet e kërkesës së hartuar nga komisioni i Njesisë kërkuese të autoritetit kontraktues si dhe çmimet e tregut fund i citatit.

Kompania 'BENI DONA PLAST' Shpk kundërshton Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e tenderit për arsye se sipas mendimit tonë jemi Ofertues të Përgjegjshëm dhe çmimet e ofruara për Lot 1 dhe Lot 2 kanë qenë çmime të tregut bile dukshëm më të favorshme se çmimet e tregut dhe Jo të marr Vendim të paligjshëm në Anulimin e Tenderit.

Prandaj, e konsiderojmë si Vendim subjektiv dhe jo ligjor. Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Anulimin e Tenderit pa e argumentuar ligjerisht bazën e vendimit të marrë.

Si rrjedhojë, edhe marrja e Vendimit të Autoritetit Kontraktues, që të Anulojë Tenderin mbi bazën e kinse papërgjegjshmërisë së çmimeve sipas letrës standarde e konsiderojmë si të pabazë dhe të paligjshëm, për arsye se ky Vendim ka dëmtuar interesat materiale – financiare të Kompanisë 'BENI DONA PLAST' Shpk të shpallet fitues i tenderit për Lot 1 dhe Lot 2 dhe të realizojë kontratën publike të fituar në pajtim të plotë me rregullat dhe procedurat e prokurimit publik të Kosovës.

Kompania 'BENI DONA PLAST' Shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP ku është përcaktuar se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera të AK duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe ose burimet tjera, gjë që është mohuar me faktin e mosdhënjes së kontratës OE Beni Dona Plast Shpk aq më parë kur të kihet parasysh se operatori ekonomik i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit, njoftim për kontratë dhe këte dispozitë ligjore, prandaj AK ka dështuar në aplikimin e drejtë dhe të plotë të kësaj dispozite ligjore, respektivisht përmbushjen e qëllimit të ligjit me vet faktin e eliminimit të operatorit mbi bazën e papërgjegjshmërisë së çmimeve të ofruara kinse mbi çmimet e tregut e që me asnjë provë relevante nuk është argumentuar nga AK e me këte nuk është arritur qëllimi i sigurimit të mënyrës më efektive dhe më të drejtë i shfrytëzimit të fondeve publike, veprim i cili rrezikon shkuarjen e mjeteve të parashikuara për këte aktivitet të prokurimit në suficit që nuk është qëllimi i ligjit e besojmë as i autoritetit kontraktues marrë parasysh se ky aktivitet i prokurimit në vitet paraprake është publikuar më shumë herë. Me këte veprim të ndërmarrë autoriteti kontraktues e ve në dyshim se është respektuar paragrafi 2 i këtij neni për marrjen e vendimeve në baza ligjore dhe faktike nga personat që përfshihen në aktivitete të prokurimit aq më parë kur të kihet parasysh përgjegjshmëria e kompanisë tonë mbi të gjitha bazat pohim dhe i vetë AK, prandaj lind dyshimi i bazuar në ekzistimin e averzitetit ndaj kompanisë tonë.

Prandaj Anulimin e këtij tenderi dhe eliminimin si të papërgjegjshëm nga ky aktiviteti i prokurimit e konsiderojmë subjektiv dhe jo ligjorë aq më parë kur të kihet parasysh se ne jemi kompani e përgjegjshme dhe kemi ofruar çmime konkurruese dhe dukshëm më të favorshme se çmimet e tregut

(shih fakt nr.1 – Neni 1 i LPP- të shiqohet)

Kompania 'BENI DONAPLAST'Shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës gjatë procesit të vlerësimit të ofertave produkt i së cilit është Njoftimi për Anulim dhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar ka shkelur dispozitat e nenit 6 të LPP ku parashifet që të gjitha AK, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë më ekonomike, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Në rastin konkret nuk është vepëruar konform kësaj dispozite ligjore me vet faktin e anulimit të tenderit dhe eliminimit jo ligjorë nga ky aktivitet i prokurimit e që kompanin tonë e pamundëson në fitimin e kontratës publike në mënyrë të drejtë dhe ligjore. (shih fakt nr.2 – dispozita e nenit 6 të LPP të shiqohet);

Shkelje tjetër të radhës që Kompania 'BENI DONAPLAST'Shpk konsideron se është bërë gjatë procedurës së vlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit është neni 59.4 i LPP ku është përcaktuar se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Në rastin konkret nuk është vepëruar sipas paragrafit 4 të këtij neni nga se kompania e jonë është e përgjegjshme dhe se tenderi i ynë ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit konstatim i faktuar dhe nga vetë autoriteti kontraktues në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar.

Andaj anulimi i tenderit dhe eliminimi mbi bazën e papërgjegjshmërisë së çmimet e ofruara për Shërbim me ushqim dhe pije në Ndërtesën e Administratës së PK në Prishtinë dhe Shërbim me ushqim dhe pije në Regjionin e Prishtinës të PK janë çmime të larta të krahasuara më çmimet e kërkesës së hartuar nga komisioni i Njësisë kërkuese si dhe me çmimet e tregut, është i pa qëndrueshëm dhe i pa argumentuar me asnjë provë relevante nga autoriteti kontraktues, sepse çmimet e ofruara nga kompania e jonë janë tejet konkurruese dhe dukshëm më të favorshme se çmimet e tregut e këtë bazuar në faktin se kemi pasë parasysh rëndësinë e veçantë të këtij institucioni shtetërorë, prandaj kemi ofruar çmime të favorshme për ta.

Bile Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të bëjë hulumtimin e tregut nga lëmia e gastronomisë, të specifikoj qdo artikull për të cilin mendon se është jashtë suazave të çmimeve të tregut, të krahasoj çmimet refernte të publikuara në web faqen e KRPP për artkujt ushqimorë me çmimet e ofruara nga kompania jonë e jo të na eliminoj me një konstatim të përgjithësuar dhe të na mohoj mundësinë e fitimit të kontratës në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Se çmimet e ofruara janë konkurruese dhe dukshëm më të favorshme se çmimet e tregut argumentohet me çmimoret e ca kompanive/restauranteve hoteliere të cilat ia bashkangjesim ankesës siq janë:Flamengo,InCorso,Rings,Aurora dhe Center.

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues i dhënë në Vendimin e datës 03.07.2017 për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim është i pa qëndrueshëm dhe jo ligjorë nga se bazohet në krahasimin e vetëm një artikulli pica e vogël me përshtut me çmimoret e një pizzerie e cila është afër SHFMU Xhemajl Mustafa të cilën ne e kemi parashtruar, e duke apstrahuar krahasimin e artikujve të njetë me çmimoren e kompanisë tjetër (Rings) poashtu të parashtruar dhe të tjerave siq është Aurora,Center etj.

Thekësojmë se vetëm ky artikull krahasuar me 87 artikujt e të dy llotëve nuk përbënë shkelje esenciale dhe nuk ndikon në ndryshim esencial të mos themi spak të qëllimit të këtij aktiviteti të prokurimit, prandaj si i tillë nuk është argument bindës për eliminim të kompanisë sonë dhe anulim të këtij aktiviteti të prokurimit aq më parë kur të kihet parasysh se kompania e jonë është e përgjegjshme dhe i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë argument i faktuar dhe nga vet AK.

Nëse kompani me traditë të gjatë në lëmin e gastronomisë nuk mundë të bëjmë krahasime me çmimet e përcaktuara nga komisioni i Njësisë kërkuese të AK nga se konsiderojmë se kjo është qështje konfidenciale e autoritetit kontraktues andaj këte qështje e konsiderojmë si qështje të kryer të autoritetit kontraktues dhe mbi këte bazë nuk kemi argument matës lidhur me këtë, andaj rezultojnë se në rastin konkret nuk është vepëruar sipas kësaj dispozite me qka edhe i është mohuar e drejta e fitimit të kontratës këtij OE për Lot 1 dhe Lot 2 (shih fakt nr.3 – Neni 59.4 i LPP të shiqohet’);

Kompania Beni Dona Plast konsideron shkelje tjetër gjatë këtij aktiviteti të prokurimit dispozitat e nenit 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik në të cilat si duket autoriteti kontraktues nuk ka pasë qasje e me këtë dhe është nxjerë një përfundim i gabuar, jo i bazuar në fakte ligjore nga ana e autoritetit kontraktues me q, rast është dëmtuar kompania e jonë gjë e cila duke pasë parasysh argumentet e parashtruara dhe praktikatat e mira ndërkombëtare nga lëmia e prokurimit nuk do duhej të kishte ndodhë (shih fakt nr.4 – Neni 41 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurimin Publik të shiqohet).

- Së fundi Kompania 'BENI DONA PLAST' Shpk konsideron se Autoriteti Kontraktues – Policia e Kosovës gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka shkelur dispozitat e nenit 10 të LPP Mjetet për promovimin e Transparencës ku në paragrafin 3 është përcaktuar se: Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në nenin paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni përveç informatave sekrete afariste, që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të këtij paragrafi, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas nenit 62.2 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur.
- Në paragrafin 4. të këtij neni është përcaktuar se Autoriteti kontraktues do të sigurojë qasjen e kërkuar nga neni paragrafi 3. i këtij neni në mënyrë të rregullt, të qetë, dhe pa pengesa. Sidoqoftë, autoriteti kontraktues mundet që të mbikëqyrë qasjen në fjalë ose të marrë masa të arsyeshme për të ruajtur integritetin e të dhënave., ndërsa në paragrafin 5 të këtij neni është paraparë që Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një personi ose pale të interesuar, do të bëjë dhe do t'i sigurojë personit ose palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin personi ose pala e tillë e interesuar ka të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Se nuk është vepëruar konform kësaj dispozite ligjore rezultojnë nga Kërkesa e operatorit ekonomik i cili me datë 28.06.2017 në Autoritetin Kontraktues ka bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa qasja e kërkuar nga AK nuk i është mundësuar me q, rast Beni Dona Plast Shpk i është pamundësuar e drejta e marrjes së dokumentacionit relevant në këte rast procesverbalit të vlerësimit të ofertës nga i cili do nxirrej dhe faktohej pretendimi ynë se a është bërë hulumtimi i çmimeve të tregut, i atyre refernte të publikuara në Web faqen e KRPP-së, se a janë specifikuar të gjithë artikujt për të cilët mendohet se janë mbi çmimet e tregut rrjedhojë e së cilës duke pasur parasysh faktin se jemi kompani e përgjegjshme neve do të ishim shpërblyer me dhënje të kontratës në mënyrë të rregullt dhe ligjore për Lot 1 dhe Lot 2, gjë që në rastin konkret nga ana e AK na është mohuar kjo e drejtë (shih fakt nr.5 – Neni 10 i LPP të shiqohet).